REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 669/23
Datë/Datum. 18.12.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP Nr:2023/0669

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje nga,Isa Hasani-Kryetarë, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Profitech " SH.P.K. - Prishtinë, kundër Vendimin për dhënie të kontratës, Ministria e Infrastrukturës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit " "Qendra mobile për kontrollim teknik te automjeteve ne rruge" me nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1",me datën 18.12.2023, mori ketë:

V E N D I M

1. Miratohet si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik, "Profitech " SH.P.K. me numër; 2023/0669, kundër "Njoftim Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Ministria Infrastrukturës, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit ""Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rruge" nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1"

2. Anulohet, "Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Ministria Infrastrukturës, i datës, 21.10.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit ""Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rruge" nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1", dhe lënda kthehet në Ri-vlerësim.

3. Lejohet kthimi i mjeteve të depozituara në emër të tarifës ankimore OE "Profitech" ,sipas paragrafi 4, 5 të nenit 31 të Rregullores së Punës së OSHP, kurse ankuesi ka të drejtë që sipas paragrafi 6, të dispozitës së cituar, të kërkojë kthimin e mjeteve në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, në të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Infrastrukturës, në cilësinë e autoritetit kontraktues më datën 13.06.2023, ka publikuar Njoftimin për Kontratë, afati i fundit për dorëzimin e tenderëve ishte me datë: 28.07.2023. Me datë 21.10.2023,ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Qendra Mobile për Kontrollim Teknik te Automjeteve në Rruge" me nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1, ku është rekomanduar për

kontratë, Grupi i operatoreve ekonomik "Traffiks VA SH.P.K; Autoinstrument dooel Skopje".

Me datë 22.08.2023 , OE ankues ka bërë Kërkesë për rishqyrtim, ndërsa me datë 29.08.2023, AK Ministria e Infrastrukturës, refuzon si të pa pabazuar Kërkesën për rishqyrtim të OE "Profitech " për aktivitetin e prokurimit lart shënuar.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e AK-se, lidhur me Kërkesën për rishqyrtime , konform nenit 108/A ka parashtruar ankese në OSHP me numër të protokollit 0669/2023.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 500,000.00 €.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP-së, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Pretendimet ankimore të operatorit ekonomik "Profitech " SH.P.K .

1.OE ankues ka parashtruar ankese kundër vendimit për dhënie të kontratës, me pretendimin se AK-ja, nuk ka respektuar procedurat e vlerësimit te ofertave. Autoriteti kontraktues, pas përfundimit të vlerësimit te ofertave e ka njoftuar OE ankues me rezultatin e vlerësimit të cilin e refuzon tenderin me arsyetimet se Operatorit Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale ne piken 4. Projekti i detajuar i cili përmban te gjitha pajisjet, se si duket një qendër mobile dhe si do te funksionoj. Dëshmia 4. - OE duhet te prezantoj një projekt detaj se si do te funksionoj kjo qendër mobile për realizimin e qëllimit te këtij projekti. Operatori ekonomike nuk ka prezantuar Projektin e detajuar sipas kërkesës te FDT-se. OE thekson se Ne në dosje të tenderit e kemi prezantuar ofertën teknike në të cilën janë të specifikuar të gjitha pajisjet e ofruara një nga një të qendrës mobile, si dhe katalogët për secilin pozicion veç e veç dhe katalogun në të cilën shihet se si duket dhe si funksionon qendra mobile.

2.Nuk keni ofruar deklaratën për Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik sipas Rregullore Nr.001_2022 për prokurimin publik Neni 26 Grup i Operatorëve Ekonomik paragrafi 26.1 ne piken c. Një deklaratë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët të grupit për të autorizuar partnerin udhëheqës të veproj në emër të grupit (deklarata elektronike mund të nënshkruhet duke përdorur nënshkrimin elektronik të avancuar nëse është i aplikueshëm; ju si grupe i operatoreve ekonomike keni paraqitur Burim Vrajollin i cili nuk është partner ne grupin e operatorit ekonomike. Sa për sqarimin tuaj Burim Vrajolli është Drejtor i Autorizuar dhe inxhinier i makinerisë në kompaninë "Profitech sh.p.k.", i

certifikuar nga Maha dhe Beissbarth për disa pajisje kalibruese që i takojnë veprimtarisë të ketij projekti.Burim Vrajolli është Drejtor i Autorizuar i Kompanisë Profitech sh.p.k. në këtë rast liderit të Grupit të Operatoreve Ekonomik dhe në pikën C. të Deklaratës për Themelimin e Grupit të Operatorëve është deklaruar shume qarte se:We below undersigned authorise Mr. Burim Vrajolli as the lead partner to act on behalf of the group,. Në faqen numër dy të Deklaratës për Themelimin e Grupit të Operatorëve shihet shumë qartë nënshkrimi dhe vula e të dy partnerëve të Grupit,

Vlen të ceket po ashtu se çmimi i ofruar nga ana jonë është për 38,890.42 Euro më i ulët se OE i rekomanduar për kontratë, ku AK në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L- 237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092,sipas Neni 1 Qëllimi, ka për qëllim të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera. dhe Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, paragrafi 1., të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Më datë 22.08.2023 kemi bërë kërkesë për qasje në dosje të tenderit tek AK dhe na është mundësuar qasje po të njëjtën datë 22.08.2023. Kemi venë re se Grupi i Operatorëve Ekonomik i rekomanduar per kontrate "TRAFFIKS VA SH.P.K. Autoinstrument dooel Skopje" është i papërgjegjshëm dhe nuk është në përputhshmëri me kërkesat në FTD të dosjes së tenderit në pikat si më poshtë: Pika 1:Sipas Rregullores Nr.001_2022 për prokurimin publik Neni 26, "Grupi i Operatorëve Ekonomik", OE te rekomanduar per kontrate i mungon Deklarata për themelimin e Grupit te Operatoreve Ekonomik gjegjësisht pika a, b, c te paragrafit 26.1.
Në bazë të UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, OE të rekomanduar për kontratë do te duhej ti refuzohej tenderi pa kërkuar informacion të mëtejshëm.
Pika 2:Ndersa Grupit te OE-ve të rekomanduar për kontratë i mungojnë referencat sipas kërkesës në FTD të dosjes së tenderit. Kontratat të cilat janë paraqitur të gjitha janë si nënkontraktuar dhe e tyre shumica janë për sinjalizim rrugor që nuk kane të bëjnë me furnizim dhe trajnim të projektit në fjalë. Pika 3:Bazuar ne Informatat mbi Biznesin te OE TRAFFIKS VA SH.P.K, OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka veprimtarinë për tenderin në fjalë. Pika 4. Grupit te OE te rekomanduar për kontrate i mungon Deklarata e Përputhshmërisë. Pika 5: Grupi i OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë Certifikatë te Konformitetit si dëshmi. Ne fund EO ankues kërkon , ankesa te miratohet s e bazuar dhe anulohet, Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të publikuar me datë: 17.08.2023, lënda të kthehet në rivlerësim.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës, ndërsa me datë 25.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2023/0669.

Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues i pakënaqur me vendimin e AK-se, konform nenit 108/A ka parashtruar ankese ne OSHP, me pretendimin se autoriteti kontaktues – Ministria e Infrastrukturës nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-se, kryesisht nenin 59 të LPP-së, me këtë rast ka rekomanduar për kontrate një operatore ekonomik i cili nuk i plotëson kriteret e dosjes se tenderit.OE ankues me datën: 17.08.2023, ka pranuar vendimin e AK-se dhe letrën standarde ku AK-ja ,e ka eliminuar me arsyetim sipas vendimit.
Eksperti shqyrtues, sa i përket arsyetimit te AK-se, se konzorciumi ne fjale nuk ka ofruar deklaratën me te cilën caktohet/autorizohet partneri udhëheqës i cili do te veproje ne emër te grupit, nuk qëndron

sepse ne piken C te deklaratës pre themelimin e konzorciumit është caktuar si udhëheqës i konzorciumit Burim Vrajolli, i cili ne certifikatën e biznesit është pronar i Profitech. Prandaj ky pretendim i OE është i qëndrueshëm.
Sa i përket pretendimit te OE ankues se i rekomanduari pre kontrate nuk i ka dorëzuar deklaratat e themelimit te konzorciummit, eksperti shqyrtues, sqaron se deklaratat e themelimit te grupit të operatoreve ekonomik, i rekomanduari për kontrate i ka ofruar sipas nenit 71 të LPP-se. Prandaj, nuk qëndron ky pretendim.
Po ashtu sa i përket pretendimit të OE ankues se i rekomanduari pre kontrate nuk i ka ofruar kontratat dhe referencat sipas kërkesës se dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk qëndron ky pretendim i OE ankues, sepse vetëm lideri i konzorciumit ka ofruar liste të kontratave me mbi 700,000.00 euro, dhe fakti qe ka qene si nënkontraktor nuk përbën element të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, sepse eksperti shqyrtues bazohet ne kërkesën e dosjes se tenderit.
Po ashtu OE ankues pretendon se i rekomanduari për kontrate duhet të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit sepse ne informatorin e certifikatës se biznesit, i rekomanduari për kontrate nuk e ka veprimtarinë adekuate. Ky pretendim nuk qëndron sepse nuk është kërkesë e dosjes se tenderit dhe eliminimit për një kërkesë e cila nuk është parashtruar në dosje të tenderit dhe njoftimin për kontratë është në kundërshtim me paragrafin 3 te nenit 56 te LPP-se.
OE ankues, pretendon se i rekomanduari për kontrate nuk e ka dorëzuar deklaratën e specifikimit teknike sipas pikës 3.1 te dosjes se tenderit, kjo nuk qëndron sepse në fajllin ku e ka ngarkuar deklaratën e themelimit te konzorciumit ne faqen nr. 6 e ka dhënë deklaratën sipas nenit 3.1 të FDT-se.
Eksperti teknik sqaron se pretendimi ankimor se Operatorit Ekonomik nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. OE ankues në dosje të tenderit e ka prezantuar ofertën teknike në të cilën janë të specifikuar të gjitha pajisjet e ofruara një nga një të qendrës mobile, si dhe katalogët për secilin pozicion veç e veç dhe katalogun në të cilën shihet se si duket dhe si funksionon qendra mobile, që do të thotë se është ofruar çdo detaj në lidhje me qendrën mobile të ofruar. Pretendimi ankimore i OE ankues se jemi eliminuar pa te drejte, është i bazuar sepse projekti i detajuar është ne përputhje me kërkesat e dosjes se tenderit.
Eksperti teknik sqaron se pretendimi ankimor se në Specifikimet teknike të detyrueshme, neni 3.1, pika a) është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a Deklaratën për specifikimet teknike për mallrat e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit. Grupit të OE të rekomanduar për kontrate i mungon Deklarata e Përputhshmërisë.
Po ashtu pretendimi ankimor se me rastin e përzgjedhjes së numëruesit të grimcave pn, Grupi i OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë Certifikatë te Konformitetit si dëshmi. Pretendimi ankimor është i pa bazuar sepse OE i rekomanduar ka ofruar Certifikatën e Konformitetit nga KBS (Organ i Vlerësimit te konformitetit) e lëshuar me 16.12.2022 dhe PTB (Instituti Federal Fiziko-Teknik), Institut Kombëtar i Metrologjisë.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues-

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve

dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Paneli shqyrtues konstaton se vlerësimet e raportit të ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit dhe dokumenteve me të cilat ka ofertuar ankuesi, andaj i falë besimin e plotë raportit të ekspertizës, me gjetjet se, Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore të LPP, lidhur me publikimin "Njoftimi Mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Ministria Infrastrukturës, i datës, 21.10.2023, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "“Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rruge" nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1".

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin si të bazuar nga eksperti, sa i përket arsyetimit të AK-se, se konzorciumi në fjale nuk ka ofruar deklaratën me te cilën autorizohet partneri udhëheqës i cili do te veproje ne emër te grupit, vërehet se piken C të deklaratës për themelimin e konzorciumit është caktuar si udhëheqës i konzorciumit Burim Vrajolli, i cili në certifikatën e biznesit është pronar i Profitech, andaj dhe Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin e OE ankues se i rekomanduari pre kontrate nuk i ka ofruar kontratat dhe referencat sipas kërkesës se dosjes se tenderit, eksperti shqyrtues ka konstatuar se vetëm lideri i konzorciumit ka ofruar liste te kontratave me mbi 700,000.00 euro, dhe fakti qe ka qene si nënkontraktor nuk përbën element qe te eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit, andaj dhe Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Po ashtu Paneli shqyrtues lidhur pretendimet ankimore, e OE i rekomanduari për kontrate nuk e ka veprimtarinë adekuate sipas certifikatës, se nuk ka dorëzuar deklaratën e specifikimeve teknike, janë verifikuar nga eksperti dhe është konstatuar se në Dosjen e tenderit janë të gjitha dokumentet valide, andaj dhe Paneli shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuara.

Paneli shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor se OE, është eliminuar nga AK me arsyetim se nuk i plotëson kriteret e përcaktuara ne Njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit. Eksperti teknik ka vërejtur se në dosje të tenderit është prezantuar oferta teknike në të cilën janë të specifikuar të gjitha pajisjet e ofruara një nga një të qendrës mobile, si dhe katalogët për secilin pozicion veç e veç, se si duket e si funksionon qendra mobile andaj, andaj Paneli konstaton se pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues lidhur pretendimin ankimor se me rastin e përzgjedhjes së numëruesit të grimcave pn, Grupi i OE i rekomanduar nuk ka ofruar asnjë Certifikatë te Konformitetit si dëshmi. Eksperti teknik ka konstatuar se OE i rekomanduar ka ofruar Certifikatën e Konformitetit nga KBS (Organ i Vlerësimit vlerësimin te konformitetit) e lëshuar me 16.12.2022 dhe PTB (Instituti Federal Fiziko-Teknik), Institut Kombëtar i Metrologjisë, andaj Paneli konstaton se pretendimi ankimor është i pabazuar.

Paneli shqyrtues konstaton se Operatori Ekonomik ankues në këtë rast ka ofruar argumente të mjaftueshme ankimore të bazuara kundër vendimit të AK, e po ashtu konstatimet dhe rekomandimi i ekspertëve shqyrtues/teknik prandaj Paneli konstaton të gjeturat e lartcekura janë prova të mjaftueshme, që ankesa e OE, të miratohet si bazuar, ndërsa anulohet vendimi i AK , "Njoftim Mbi

Vendimin e Autoritetit Kontraktues", Ministria Infrastrukturës, për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit ""Qendra Mobile për Kontrollim Teknik të Automjeteve në Rruge" nr. të prokurimit: "205-23- 6058-1-1-1" dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues janë të qëndrueshme ashtu siç janë dhënë në konstatimin e panelit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Lidhur me tarifën ankimore, Paneli Shqyrtues vendosi konform nenit 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP, lidhur me nenin 118 të LPP.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E INFRASTRUKTURES, MINISTRIA E INFRASTRUKTURES**
- OE - **" BE NEW " L.L.C., " Profitech " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: